

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje Karburanti”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

09100000-0 - Karburante.

VLERA E FONDIT LIMIT:

34,548,218 (tridhjetë e katër milion e pesëqind e dyzet e tetë mijë e dyqind e tetëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH, konvertuar në vlerën 352,281 (treqind e pesëdhjetë e dy mijë e dyqind e tetëdhjetë e një) Euro pa TVSH, sipas kursit të këmbimit datë 11.06.2025 (1 EUR = 98.07 Lekë).

Argumentimi në lidhje me nenin 39 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, për mosndarjen e procedurës së prokurimit në lote:

Procedura e prokurimit për “Blerje Karburanti”, synon furnizimin e automjeteve të OST sh.a. me karburantet e nevojshme për të kryer veprimtarinë e Autoritetit Kontraktor.

OST sh.a. zotëron disa automjete që janë të ndryshme për sa i përket furnizimit me karburant, pra naftë dhe një pjesë shume e vogël me benzinë.

Për të kryer aktivitetin e nevojshëm, këto mjete pune duhet të shkojnë në destinacion në grup dhe furnizimi i mundshëm i disa prej tyre në pika të ndryshme, në rast se kjo kontratë do të ndahej në lote, do të vështirësonte punën e ekipit të punonjësve, pasi do të duhej të ndaheshin për të kryer furnizimin me karburant, secili në pikën e karburantit sipas kontratës së lotit përkatës.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor nuk mund t’a ndajë këtë procedurë prokurimi në lote, pasi do të shkaktonte vonesa dhe vështirësi në kryerjen e aktivitetit të automjeteve.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **“Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, të paktën 69,000,000 (gjashtëdhjetë e nente milion) Leke.*

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove për plotësimin e këtij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë vertetim nga Administrata Tatimore ku të tregohet xhiroja vjetore për vitet e sipërpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marre ne konsiderate sasinë dhe cilesine e mallrave objekt procedure prokurimi, kerkohet qe OE ofertues te paraqese se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare per ta realizuar ate ne kohe dhe ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara. Per kete, OE ofertues duhet te kete disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me kete qellim, eshte argumentuar se vlera e xhiros per tre vitet e fundit financiare te jete ne masen 69,000,000 (gjashtëdhjetë e nente milion) Lekë.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata te ngjashme ne nje vlere te pakten prej 13,000,000 (trembedhjetë) Lekë pa TVSH.

Lidhur me kete pike:

Kur OE ka realizuar kontrata me nje ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën 37 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marre ne konsiderate sasine dhe cilesine e mallrave objekt procedure prokurimi, eshte menduar se vlera e kerkuar qe OE ofertues te kete bere me kontrata te ngjashme, te jete 37 % të vlerës te fondit. Ne kete menyre, AK ka sigurine dhe besueshmerine qe OE ofertues mund te realizoje kontraten objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurine e punes se AK.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Lejën e Tregëtimit të Karburanteve, në përputhje me Ligjin Nr. 8450, date 24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” i ndryshuar.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e pikes 5/a te nenit 40, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne lidhje ushtrimin e aktivitetit objekt procedure prokurimi.

2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues duhet të garantojë furnizimin me karburant sipas standarteve shtetërore në fuqi S SH EN 590:2022 per Gazoil (10 ppm ULSD) dhe S SH EN 228:2012+A1:2017 per Benzine (Premium Unl 10 ppm), me tollona (bileta) të vlefshme në pika shitje karburanti (me shërbim 24 orë, çdo ditë të javës), të vendosura në qytetet e mëposhtme, në të cilat ushtrojnë aktivitetin Njësitë Operative të OST sh.a.: Tiranë, Durrës, Shkodër, Lezhë, Burrel, Elbasan, Lushnjë, Fier, Vlorë, Korçë, Gjirokastrë, Sarandë.*

Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri kualifikues, ofertuesi duhet të paraqesë një deklaratë, sipas të cilës merr përsipër dhe garanton gjithçka sa më sipër dhe ku të cilësohen emërtimet e pikave, vendndodhjet dhe adresat e sakta të tyre, numrat e telefonit dhe personi i kontaktit. Informacioni për pikat e furnizimit në qarqet e mesiperme duhet të jetë njëkohësisht i verifikueshëm nëpërmjet ekstraktit të QKB-së. Në deklaratë të cilësohet gjithashtu që (tollonat) bilete do të përmbajnë emrin tregëtar të shoqërisë/ve kontraktuese, si dhe do të jenë pa afat skadence, dhe të përmbajnë të gjithë elementet e sigurisë.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e pikes 4/c te nenit 40, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne lidhje ushtrimin e aktivitetit objekt procedure prokurimi.

Gjithashtu, në lidhje me kërkesën për pika karburanti në qytetet e mesiperme dhe në shërbim 24 orë, është e lidhur ngushtësisht me veprimtarinë e OST sh.a. e cila ushtrohet në qytete e mesiperme nëpërmjet njërive operative të OST sh.a.

Persa i përket kërkesës për furnizim me karburant 24 ore ne cdo dite te javes eshte i rendesishem pasi veprimtaria e OST sh.a. eshte e tille qe ushtrohet 24 ore ne dite.

2.3.4 *Operatori ekonomik duhet të ketë paguar taksat vendore për gjithë vitin 2024. Për këtë duhet të disponojë të gjithë dokumentacionin provues nga Drejtorite Rajonale të Tatimeve.*

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me parashikimet e pikes 2, te nenit 76, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe i jep sigurinë Autoritetit Kontraktor që OE ofertues plotëson detyrimet ligjore për të marrë pjesë në prokurimet publike.

2.3.5 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë analizat e furnizimit të fundit para zhdoganimit ose raport-analiza të lëshuara nga autoritetet përkatëse, jo më parë se 3 (tre) muaj nga data e hapjes së ofertave, të bëra nga laborator i ISHTI-it, apo organe të tjera të akredituara, për Artikujt Gazoil (10 ppm ULSD) dhe Benzine (Premium Unl 10 ppm), në përputhje me standartet shqiptare, shoqëruar me certifikatën e origjinës dhe cilësisë së mallit.*

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e pikes 4/c, te nenit 40, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne lidhje ushtrimin e aktivitetit objekt procedure prokurimi. Ky kriter i jep sigurine Autoritetit Kontraktor qe malli objekt procedure prokurimi ka standardet e nevojshme.

2.3.6 *Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikatat e vlefshme te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, qe kane lidhje me objektin e kontrates, si me poshte:*

- *ISO 14001: për sistemin e menaxhimit të cilësisë së mjedisit.*
- *ISO 9001: për sistemin e menaxhimit të cilësisë.*
- *ISO 45001: për sistemin e menaxhimit te sigurise ne pune.*

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve të bashkimit duhet t'i disponojë këto certifikata.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne baze te Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku percaktohet se këto Certifikata duhet të jenë të lëshuara nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për te kryer sherbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Certifikata per menaxhimin e cilesise ISO 9001: eshte referimi i njohur ne nivel nderkombetar, per certifikimin e sistemit te menaxhimit te cilesise te kompanive te te gjithë sektoreve dhe te gjithë permasave. Ky kriter kerkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Standardi i menaxhimit te cilesise se mjedisit ISO 14001: eshte kerkuar nga AK pasi garanton se OE ofertues eshte i kujdesshem ndaj mjedisit, duke tregtuar edhe lende te cilat kane ndikim te

theksuar ne mjedis, kjo edhe sipas parashikimeve te pikes 7/c, te nenit 40, te VKM Nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar.

Certifikata për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001: është vendosur si kriter kualifikues per operatorët ekonomik ofertues sepse ka te beje me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila është me nje rendesi te vecante per kryerjen e ketij sherbimi. OE ofertues qe do te realizoje kontraten objekt procedure prokurimi duhet te kryeje sherbimin edhe prane AK, ne rastin kur do furnizojë me karburant automjete te renda te cilat nuk mund te paraqiten prane pikave te OE.

AK duhet te marre çdo mase te nevojshme per parandalimin dhe mos cenimin e veprimtarise se saj.

Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe nenin 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

2.3.7 *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Leje mjedisore te tipit B, te leshuar nga QKL, Akt-Teknik te leshuar nga PMNZH, dhe Police Sigurimi lëshuar nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi.*

Argumentimi: Kjo kerkese është e rendesishme pasi garantojn Autoritetin Kontraktor qe operatori ekonomik ofertues siguron perputhshmerine e aktivitetit te tij me kerkesat mjedisore duke garantuar reduktimin, minimizimin apo shmangin e ndikimeve ne mjedis te instalimeve ndotese, duke respektuar standartet kombetare. Akti teknik leshuar nga PMNZH është i rendesishem pasi tregon qe operatori ekonomik ofertues ka marre masa dhe vepron ne perputhje me legjislacion Shqiptar.

2.3.8 *Bazuar ne VKM Nr. 561 date 29.07.2016 “Per standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshem” i ndryshuar, Operatorët ekonomik pjesemarres duhet te ofrojne nje faqe menaxhimi te karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit per mjetet efektive te transportit te kryhet nepemjet kartes elektronike.*

2.3.9 *Faqja e menaxhimit te karburanteve (webpage) duhet te ofroje sherbimin e ngarkimit te sasise se karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qellim qe rimbushja e kartave elektronike te personalizuar me targon e mjetit si dhe administrimi i sasise se karburanteve te kryhet nga Autoriteti Kontraktor.*

2.3.10 *Faqja e menaxhimit te karburanteve duhet te ofroje edhe sherbimin per krijimin e strukture piramidale ne perputhje me strukturen piramidale te Autoritetit Kontraktor, sherbimin e furnizimit me karburant nepermjet kartave elektronike stikera (pulla), te cilat ngjiten ne xhamin e automjetit dhe ofrojne sherbimin e furnizimit me karburant vetem per ate automjet per te eliminuar levizjen e mundshme te targave nga mjetet e AK drejt mjeteve*

private, si dhe shërbimin e dërgimit të fotografive me anë të e-mailit për cdo furnizim të kryer të mjetit pranë stacionit të shitjes së karburanteve me pakicë me qëllim identifikimin e mjetit dhe përdoruesit të saj.

2.3.11 *Disponimi / Ekzistenca e faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), së bashku me ofrimin e shërbimeve të kërkuara me sipër, do të demonstrohen nga ana e operatorëve ekonomik pjesëmarrës me shembuj për zbatimin në praktikë, në prani të anëtarëve të KVO-së së Autoritetit Kontraktor përpara mbylljes së procesit të kualifikimit dhe shpalljes së fituesit.*

2.3.12 *Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara me sipër në mënyrë elektronike nëpërmjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), që ofron cdo Operator Ekonomik pjesëmarrës përben kusht për skualifikim.*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje dhe në zbatim me VKM Nr. 561 datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar.

Kërkesa për disponimin e një website të furnitorit është e rëndësishme pasi furnizimi i karburantit me kartë elektronike, transferimi i sasisë së karburantit nga furnitor tek AK-ja bëhet në mënyrë elektronike, vetëm nëpërmjet website të furnitorit.

2.3.13 *Autoriteti kontraktor për nevojat e veta, për shkak të llojeve të vecanta të disa mjeteve që disponon, kërkon që Operatoret Ekonomik ofertues të ofrojnë përveç shërbimit të furnizimit nëpërmjet kartës elektronike edhe shërbimin e furnizimit me karburant me anë të tollonave (biletave) sipas kërkesës së Autoritetit kontraktor.*

Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri Operatoret Ekonomik ofertues duhet të deklarojë se ofron edhe shërbimin e furnizimit me karburant me anë të tollonave (biletave) sipas kërkesës së Autoritetit kontraktor.

2.3.14 *Operatori Ekonomik ofertues, duhet të disponojë (në pronësi ose me qira) të paktën 2 (dy) autobote me kapacitet secili nga 1,000 deri në 5,000 Litra, për transportimin e karburantit pranë pikave të ushtrimit të aktivitetit të OST sh.a., sipas kërkesës së saj.*

Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri Operatoret Ekonomik ofertues duhet të disponojë për secilin autobus: certifikatën e pronësisë ose kontratën e qirasë, leje qarkullimi, siguracionin (e vlefshëm), kolaudimin (e vlefshëm) dhe foto.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Dy kriteret e mesiperme jane vendosur duke pasur parasysh faktin qe Autoritetit Kontraktor OST sh.a. nisur nga fusha e veprimtarise se vet posedon mjete te ndryshme te cilat domosdoshmerisht duhet te furnizohen me karburant. AK ka ne pronesi mjete te tonazhit te rende si vinca, makineri te vecanta etj, te cilat e kane te pamundur te furnizohen prane pompave te ofertuesit, per kete qellim kerkohet nga OE ofertues sherbimi i furnizimit me karburant me ane te tollonave por edhe autobotet per transportimin e karburantit atje ku OST sha, e ka te nevojshme, ne varesi te kerkesave te saj.

2.3.15 Ne funksion te plotesimit te Shtojces 9 “Formulari permbledhes i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Ames, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i ketyre personave kerkon te dhëna te sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike jane hartuar duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per mallrat objekt procedure prokurimi, duke perlllogaritur sasite e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik” i ndryshuar.